

UDHËZIM
Nr. 160, datë 2.9.2024

**PËR PËRCAKTIMIN E RREGULLAVE DHE PROCEDURAVE PËR
PËRZGJEDHJEN E KANDIDATIT PËR DREJTOR TË PËRGJITHSHËM
TË POLICISË SË SHETIT**

Në mbështetje të pikës 4 të nenit 102 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, të pikës 2 të nenit 56 të ligjit nr. 82/2024 “Për Policinë e Shtetit”,

UDHËZOJ:

KREU I
TË PËRGJITHSHME

Neni 1

Qëllimi

1. Ky udhëzim ka për qëllim të përcaktojë rregullat dhe procedurat që lejojnë Ministrin e Brendshëm të kryejë një proces objektiv, transparent, dhe gjithëpërfshirës për përzgjedhjen, renditjen dhe propozimin e kandidatëve për Drejtor të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit.

2. Procesi i vlerësimit dhe përzgjedhjes bazohet dhe respekton parimin e mundësive të barabarta, meritokracisë dhe mosdiskriminimit.

Neni 2

Procesi i përgjithshëm i përzgjedhjes

1. Propozimi për Drejtor të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit bëhet pas kryerjes së një procesi të hapur, i cili organizohet nga Ministria e Brendshme.

2. Ministria e Brendshme shpall thirrjen për paraqitjen e shprehjes së interesit për pozicionin e Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit. Thirrja për paraqitjen e shprehjes së interesit qëndron e hapur për 7 ditë.

3. Ministria e Brendshme përcakton në thirrje adresën e postës elektronike, si dhe adresën postare në të cilën aplikantët dorëzojnë shprehjet e interesit.

4. Pas përfundimit të afatit 7-ditor për paraqitjen e shprehjes së interesit, Ministria e Brendshme publikon në faqen zyrtare emrat e kandidatëve.

5. Brenda 10 ditëve pune nga përfundimi i afatit të dorëzimit të shprehjeve të interesit, Komisioni i Posaçëm (në vijim Komisioni) kryen vlerësimin paraprak, me qëllim verifikimin e plotësimit të kushteve ligjore, të përcaktuara në nenin 4 të këtij udhëzimi. Nëse është e nevojshme, Komisioni kërkon informacione të mëtejshme prej kandidatit, institucioneve publike, apo punëdhënësit të kandidatit.

6. Në përfundim të vlerësimit paraprak, Komisioni harton listën e kandidatëve që plotësojnë kushtet ligjore dhe të kandidatëve që nuk i plotësojnë këto kushte bazuar në dokumentacionin e paraqitur nga kandidati dhe dokumentacionin shtesë të mbledhur nga Komisioni.

7. Komisioni merr vendim për përjashtimin e kandidatëve që nuk plotësojnë kushtet ligjore dhe i njofton me shkrim kandidatët e përjashtuar, në mënyrë të posaçme dhe të arsyetuar për shkaqet e përjashtimit.

8. Komisioni organizon seancë dëgjimore me kandidatët dhe i njofton ata të paktën 3 ditë para seancës dëgjimore. Anëtarët e Komisionit i drejtojnë pyetje kandidatit në përputhje me kriteret e vlerësimit sipas këtij udhëzimi.

9. Anëtarët e Komisionit vlerësojnë të gjithë informacionin e vënë në dispozicion prej kandidatëve, dokumentacionin e mbledhur dhe informacionin e marrë gjatë seancës dëgjimore, në përputhje me këtë udhëzim dhe i dorëzojnë Ministrit renditjen e kandidatëve, së bashku me vlerësimet me shkrim, sipas shtojcës “C” të këtij udhëzimi, për secilin kandidat.

Neni 3
Komisioni i Posaçëm

1. Procesi i verifikimit të përmbushjes së kriterëve dhe i vlerësimit të kandidatëve bëhet nga Komisioni i Posaçëm, me përbërjen si vijon:

- a) Një nga zëvendësministrat, i caktuar nga Ministri i Brendshëm, kryetar;
- b) Sekretari i Përgjithshëm i Ministrisë së Brendshme, anëtar;
- c) Drejtori i Përgjithshëm i Agjencisë së Mbikëqyrjes Policore, anëtar.

2. Vendimet për kualifikimin ose skualifikimin e aplikantëve merren me shumicën e votave, ndërsa vendimet për vlerësimin e kandidatëve merren individualisht nga çdo anëtar i Komisionit, sipas rregullave të përcaktuara në këtë udhëzim.

KREU II
**KUSHTET DHE KRITERET QË DUHET TË PLOTËSOJNË KANDIDATËT,
MËNYRA E VLERËSIMIT**

Neni 4
Kushtet ligjore për emërimin e Drejtorit të Përgjithshëm

1. Kandidati për Drejtor të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit paraqet dokumente që provojnë se plotëson kushtet e parashikuara në nenin 56, të ligjit për Nr. 82/2024 “Për Policinë e Shtetit”. Kandidati dorëzon dokumente mbështetëse për secilin prej kushteve ligjore si më poshtë:

- a) mban njërën nga gradat e rolit të mesëm drejtues;
- b) të ketë shtetësi shqiptare;
- c) të mos ketë qenë i dënuar për kryerjen e një vepre penale, me vendim gjyqësor të formës së prerë;
- ç) të mos ketë marrë masat disiplinore të përcaktuara në shkronjat “c”, “ç” dhe “d” të pikës 1 të nenit 123 të ligjit 82/2024 “Për Policinë e Shtetit”, brenda 5 (pesë) vjetëve të fundit;
- d) të jetë në kushte shëndetësore që e lejojnë të kryejë detyrën përkatëse.
- dh) të mos ketë konflikt interesi në ushtrimin e detyrës, në përputhje me legjislacionin për konfliktin e interesit.

2. Kandidatët duhet të dorëzojnë vetëdeklarimin sipas ligjit “Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike”.

Neni 5
Vlerësimi i kandidatëve

1. Kandidatët që përmbushin kushtet e parashikuara në nenin 4, vlerësohen dhe renditen sipas kriterëve në vijim:

- a) aftësitë profesionale të kandidatit në fushën e rendit ose sigurisë, sipas parashikimeve të detajuara në nenin 6 të këtij udhëzimi;
- b) integriteti moral i kandidatit, sipas parashikimeve të detajuara në nenin 7 të këtij udhëzimi;
- c) aftësitë organizative dhe drejtuese, sipas parashikimeve të detajuara në nenin 8 të këtij udhëzimi;
- ç) elementet plotësuese për vlerësim sipas parashikimeve të detajuara në nenin 9 të këtij udhëzimi.

2. Në rastet kur kandidatët kanë të njëjtën meritë, vlerësohet vjetërsia në ushtrimin e profesionit dhe përvoja profesionale.

Neni 6
Vlerësimi i aftësive profesionale

Vlerësimi i aftësive profesionale të çdo kandidati bazohet në kriteret e mëposhtme:

- a) kohëzgjatja dhe përshtatshmëria e përvojës në punë me pozicionin për të cilin konkurron;

b) rezultatet e vlerësimeve profesionale ose etike të kandidatëve në pozicionet e mëparshme, nëse ka, ose rezultatet e arritura gjatë përvojave të tyre të punës që lidhen me ushtrimin e funksioneve në fushën e rendit ose sigurisë;

c) rezultatet e arritura gjatë studimeve të larta dhe në kurse trajnimi të certifikuar në Shqipëri dhe jashtë Shqipërisë;

ç) rezultatet e arritura gjatë studimeve pasuniversitare në fushën e rendit ose sigurisë;

d) punime akademike, studime shkencore, shkrime dhe ligjërata profesionale, botime, pjesëmarrje në aktivitete shkencore (përveç atyre që kanë shërbyer për fitimin e gradës shkencore), pjesëmarrje në procesin e hartimit ose të konsultimit të legjislacionit dhe çdo angazhim tjetër profesional i kandidatit gjatë 5 viteve të fundit në fushën e rendit ose sigurisë.

Neni 7

Vlerësimi i integritetit moral

1. Vlerësimi i çdo kandidati në lidhje me integritetin moral bazohet në kriteret e mëposhtme:

a) reputacioni që kandidati gëzon në shoqëri dhe te kolegët, si rezultat i aktivitetit të tij profesional bazuar në cilësitë morale si ndershmëria, përpikëria në kryerjen e detyrave, drejtësia në marrjen e vendimeve dhe llogaridhënia;

b) reputacioni që kandidati gëzon në shoqëri dhe te kolegët, si rezultat i aktiviteteve të kryera gjatë kohës që nuk ushtron funksionin e tij bazuar në cilësitë morale si besueshmëria, paanshmëria, dinjiteti, veprimtaritë sociale ose kulturore.

2. Vlerësimi për integritetin moral bëhet përmes dokumenteve të dorëzuara nga kandidatët, dokumenteve të mbledhura nga Komisioni, të dhënave nga seancat dëgjimore, raportimeve në media, të dhënave publike ose burimeve të tjera të besueshme.

Neni 8

Vlerësimi i aftësive organizative dhe drejtuese

1. Vlerësimi i çdo kandidati për aftësitë organizative dhe drejtuese bazohet në kriteret e mëposhtme:

a) cilësia e platformës dhe vizionit që ata paraqesin sipas shtojcës A të këtij udhëzimi;

b) aftësitë e provuara në marrjen e vendimeve dhe përgjegjësi, bazuar në përvojat e mëparshme profesionale dhe shoqërore;

c) aftësitë në komunikim;

ç) aftësia për të punuar në grup dhe në mjedise multidisiplinare dhe/ose multikulturore;

d) aftësia për përfaqësim në publik.

2. Komisioni vlerëson përmbushjen e kriterëve të mësipërme bazuar në dokumentet e dorëzuara nga kandidati, të mbledhura nga Komisioni dhe të dhëna të mbledhura gjatë seancës dëgjimore me kandidatin.

3. Kandidati ka barrën për të sjellë prova që tregojnë aftësitë organizative dhe drejtuese të renditura në pikën 1 të këtij neni.

Neni 9

Elemente shtesë për vlerësim

1. Krahas kriterëve të përcaktuar në nenin 6, 7, dhe 8 të këtij udhëzimi, kandidatët mund të vlerësohen edhe për kriteret e mëposhtme:

a) mbajtja e titujve akademikë;

b) studimet dhe trajnimet afatgjata të kryera jashtë vendit, jo më pak se dy javë në fushën e rendit ose sigurisë ose aftësive menaxheriale;

c) zotërimi i gjuhëve të huaja, duke i dhënë përparësi gjuhëve zyrtare të Këshillit të Evropës.

2. Komisioni vlerëson zotërimin e gjuhëve të huaja përmes dokumenteve zyrtare të njohura të dorëzuara dhe/ose përmes intervistës me kandidatin.

KREU III PROCEDURA E APLIKIMIT

Neni 10

Thirrja për paraqitjen e shprehjes së interesit

1. Thirrja për paraqitjen e shprehjes së interesit për pozicionin e Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit publikohet në faqen zyrtare të Ministrisë së Brendshme dhe të Drejtorisë së Përgjithshme të Policisë së Shtetit, si dhe në mediat e shkruara dhe audiovizive.

2. Thirrja qëndron e hapur për 7 ditë. Ky afat mund të zgjatet me urdhër të Ministrit të Brendshëm.

Neni 11

Shprehja e interesit

1. Kandidatët paraqesin një kërkesë me shkrim drejtuar Ministrit të Brendshëm për të shprehur interesin dhe për të dëshmuar kualifikimet e tyre për pozicionin e Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit.

2. Kandidati duhet të paraqesë një aplikim të plotë, në mënyrë që të merret në konsideratë. Vlerësimi bëhet mbi bazën e dokumenteve të dorëzuara.

3. Kërkesa me shkrim shoqërohet nga dokumentet e mëposhtme:

a) një jetëshkrim i përditësuar;
b) një platformë personale e qëllimeve dhe objektivave që kandidati propozon të ndjekë. Ky dokument duhet të jetë punë origjinale e kandidatit dhe nuk duhet të kalojë 20 faqe, në llojin e shkrimit *Times New Roman*, madhësia 12, me një njësi hapësirë mes rreshtave;

c) një vetëdeklarim sipas ligjit nr. 138/2015 “Për garantimin e integritetit të personave të zgjedhur, emëruar ose që marrin funksione publike”;

ç) dëshmi të gjendjes gjyqësore lëshuar nga organi kompetent shtetëror, e lëshuar jo më herët se 3 muaj nga data e paraqitjes së shprehjes së interesit;

d) vërtetimin/dokumentacionin e përshtatshëm që provon përvojën e punës së kandidatit për pozicionin për të cilin konkurron;

dh) rezultatet e vlerësimit profesional dhe etik të kandidatëve në punët që kanë bërë në të shkuarën, nëse ka, apo rezultatet e arritura gjatë përvojave të tyre të punës, që lidhen me ushtrimin e funksioneve në fushën e rendit dhe sigurisë;

e) rezultatet e arritura gjatë studimeve të larta dhe në trajnime dhe kurse të certifikuara, brenda dhe jashtë vendit;

ë) rezultatet e arritura gjatë studimeve pasuniversitare në fushën e rendit ose sigurisë;

f) kopje të noterizuara të dëshmive të gjuhëve të huaja sipas pikës 1, shkronja “c”, të nenit 9 të këtij udhëzimi, nëse ka;

g) kopje të noterizuara të gradës shkencore ose titujve akademikë, nëse ka;

gj) kopje të vërtetimit të besueshmërisë, të marrë nga komisariati përkatës, e lëshuar jo më herët se 3 muaj nga data e paraqitjes së shprehjes së interesit;

h) dokumentin shëndetësor që dëshmon aftësinë për punë, e lëshuar jo më herët se 3 muaj nga data e paraqitjes së shprehjes së interesit;

i) një vetëdeklarim që kandidati nuk është në konflikt interesi në ushtrimin e detyrës;

j) një vetëdeklarim që kandidati nuk është larguar nga puna më parë për shkaqe disiplinore dhe që nuk ka masë disiplinore në fuqi në momentin e kandidimit;

k) autorizimet për Ministrinë e Brendshme/Komisionin sipas shtojës B të këtij udhëzimi.

4. Shprehja e interesit dhe të gjitha dokumentet e kërkuara duhet t'i dorëzohen Komisionit deri në datën e përfundimit të afatit, në adresën postare dhe elektronike të shënuar në thirrjen për paraqitjen e shprehjes së interesit.

Neni 12

Publikimi i listës së aplikantëve

Pas kalimit të afatit për të paraqitur shprehje interesi, Komisioni shqyrton aplikimet dhe publikon emrat e aplikantëve në faqen zyrtare të Ministrisë së Brendshme. Publikimi duhet të bëhet jo më vonë se 2 ditë pune pas mbylljes së thirrjes për paraqitjen e shprehjes së interesit.

Neni 13

Informacion shtesë përveç shprehjes së interesit

1. Komisioni, kur e sheh të nevojshme, kërkon informacione të mëtejshme nga kandidatët, organet publike ose punëdhënësi i kandidatit.
2. Kërkesa duhet të përshkruajë qartë informacionin që nevojitet dhe të përcaktojë afatin dhe vendin e paraqitjes së tij.

KREU IV

PROCEDURA PËR VLERËSIMIN PARAPRAK

Neni 14

Verifikimi i kushteve ligjore

1. Komisioni shqyrton dokumentet e dorëzuara nga kandidatët dhe nga institucionet brenda 10 ditëve pune nga dita e mbylljes së thirrjes për dorëzimin e dokumenteve, me qëllim verifikimin kushteve ligjore të parashikuara në nenin 4 të këtij udhëzimi.
2. Komisioni përcakton nëse do të kërkohej informacion shtesë nga kandidati, institucioni shtetëror ose punëdhënësi i kandidatit. Komisioni kërkon informacion shtesë në përputhje me procesin e parashikuar në nenin 13 të këtij udhëzimi.
3. Nëse Komisioni nuk merr informacion të mjaftueshëm për të përmbushur detyrën e tij për verifikimin e kriterëve ligjore, mund të vendosë një afat shtesë për të marrë informacionin e duhur.
4. Komisioni harton një listë të kandidatëve që plotësojnë kriteret ligjore dhe një listë të atyre që nuk plotësojnë kushtet ligjore së bashku me një raport mbi rezultatet e verifikimit të kriterëve ligjore bazuar në dokumentacionin e dorëzuar dhe atë të mbledhur.
5. Komisioni merr vendim për përjashtimin e kandidatëve dhe njofton me shkrim dhe në mënyrë të arsyetuar çdo person të përjashtuar. Njoftimet nënshkruhen nga kryetari dhe i dërgohen secilit kandidat të përjashtuar, me postë rekomande, ditën vijuese të punës.

Neni 15

Verifikimi i integritetit të kandidatit

1. Aplikanti dorëzon bashkë me aplikimin pranë Ministrisë së Brendshme, kopjen fizike të formularit për vetëdeklarim sipas ligjit nr. 138/2015 “Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike”.
2. Për aplikantët që plotësojnë kriteret ligjore, Ministri i Brendshëm i përcjell menjëherë formularin e vetëdeklarimit sipas ligjit nr. 138/2015, të plotësuar nga kandidati, në Prokurorinë e Përgjithshme. Vetëdeklarimi i kandidatit sipas ligjit nr. 138/2015 bëhet publik në faqen zyrtare të Ministrisë së Brendshme.
3. Komisioni mund të kryejë edhe veprimet për kërkimin e informacionit, sipas kompetencës përkatëse, nga Autoriteti Kombëtar për Sigurinë e Informacionit të Klasifikuar, Shërbimi Informativ i Shtetit, shërbimet e tjera të inteligjencës dhe prokuroria. Kandidati plotëson dhe nënshkruan autorizimin sipas shtojcës B të këtij udhëzimi, ku autorizon Komisionin të kryejë verifikimet përkatëse.
4. Në varësi të rezultateve të kontrollit dhe nevojave të verifikimit të mëtejshëm të integritetit të kandidatit, Komisioni mund të kërkojë:
 - a) informacione shtesë nga institucionet e përmendura në këtë nen;
 - b) shpjegime me shkrim nga kandidati, i cili jo më vonë se 3 ditë nga marrja dijeni, duhet të paraqesë drejtpërdrejt pranë Komisionit, shpjegimet e tij dhe dokumentet mbështetës ose shprehjen e vullnetit për tërheqjen nga kandidimi.

5. Nëse nga gjetjet dhe përfundimet e raportit të Prokurorisë së Përgjithshme, si edhe gjetjet e përfundimet e nxjerra nga të dhënat e dërguara nga institucionet e tjera të përmendura në këtë nen, Komisioni vlerëson se nuk ka të dhëna që mund të sjellin ndalimin e kandidimit, vijon me procedurën e vlerësimit të kandidatit.

6. Nëse nga gjetjet dhe përfundimet e raportit të Prokurorisë së Përgjithshme, si edhe të atyre të dërguara nga institucionet e tjera të përmendura në këtë nen, Komisioni vlerëson se ka të dhëna që mund të sjellin përjashtimin e kandidatit, Komisioni merr vendim për përjashtimin e kandidatit dhe e njofton me shkrim dhe në mënyrë të arsyetuar. Njoftimet nënshkruhen nga kryetari dhe i dërgohen secilit kandidat të përjashtuar, ditën vijuese të punës.

7. Përjashtimi vendoset edhe kur kandidati ka refuzuar të përmbushë detyrimin për të dorëzuar formularin e vetëdeklarimit sipas kërkesave të ligjit nr. 138/2015.

KREU V PROCEDURA PËR VLERËSIMIN NGA KOMISIONI

Neni 16

Zhvillimi i seancave dëgjimore

1. Komisioni cakton datën dhe orën e seancës dëgjimore. Seanca për secilin kandidat mbahet në praninë e më shumë se gjysmës së anëtarëve të Komisionit.

2. Në seancën dëgjimore, i jepet fjala kandidatit i cili ka në dispozicion 20 minuta për të bërë një prezantim.

3. Pas prezantimit, çdo anëtar i Komisionit ka të drejtë t'i drejtojë pyetje kandidatit. Pyetjet do të përqendrohen në kompetencën e kandidatit në fushën e:

a) rezultateve të vlerësimit profesional të kandidatit në fushën e rendit ose sigurisë, sipas parashikimeve të detajuara në nenin 6;

b) integritetit moral të kandidatit, sipas parashikimeve të detajuara në nenin 7;

c) aftësive organizative dhe drejtuese, sipas parashikimeve të detajuara në nenin 8;

ç) elementeve shtesë të vlerësimit sipas parashikimeve të detajuara në nenin 9.

4. Kandidatëve u lihet kohë e mjaftueshme në dispozicion për t'u përgjigjur për çdo pyetje.

5. Komisioni mund të kërkojë informacion shtesë nga burimet përkatëse në përputhje me nenin 13 të këtij udhëzimi.

6. Pas përfundimit të seancës dëgjimore, Komisioni zhvillon një seancë të mbyllur për të vlerësuar cilësitë e secilit kandidat. Komisioni do të shqyrtojë çdo dokument të nevojshëm për vlerësimin e kandidatit.

Neni 17

Procedura e vlerësimit

Secili nga anëtarët e Komisionit do të përdorë formularin e vlerësimit në shtojcën C të këtij udhëzimi. Anëtari do të përdorë dokumentet në dispozicion dhe informacionin e dhënë gjatë seancës dëgjimore për të përfunduar vlerësimin. Anëtarët e Komisionit i dorëzojnë vlerësimet për secilin kandidat Ministrit të Brendshëm.

Neni 18

Vendimmarrja përfundimtare e Ministrit

1. Brenda 48 orëve nga seanca e fundit dëgjimore, Komisioni përpunon të dhënat dhe harton tabelën përfundimtare të vlerësimit të kandidatëve. Komisioni rendit kandidatët sipas pikëve të marra duke filluar nga kandidati që ka marrë më shumë pikë.

2. Në rastet kur kandidatët kanë pikë të barabarta, ata do të listohen në bazë të vjetërsisë në profesion dhe në përvojën profesionale.

3. Në përfundim të renditjes, ministri i propozon kryeministrit një nga kandidatët me vlerësimin më të lartë. Propozimi i ministrit shoqërohet me një relacion i cili shpjegon procesin e ndjekur,

kandidatët që u kualifikuan si dhe shkaqet për propozimin e kandidatit përkatës për Drejtor të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit.

KREU VI DISPOZITA TË FUNDIT

Neni 19 **Konflikti i interesit**

Anëtari i Komisionit, që ka pengesa ligjore në kuptim të ligjit nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative”, si dhe ka konflikt interesi në kuptim të ligjit nr. 9367, datë 7.4.2005 “Për parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike”, heq dorë nga detyrat e tij/saj në procesin e vlerësimit dhe renditjes së kandidatëve. Në këtë rast, ministri zëvendëson anëtarin me një anëtar tjetër.

Neni 20 **Komunikimet jozyrtare gjatë procesit të përzgjedhjes**

Anëtarët e Komisionit dhe kandidatët për Drejtor të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit duhet të shmangin komunikimet jozyrtare mes tyre, duke filluar nga data e shpalljes së vendit vakant deri në ditën e përfundimit të procesit për vlerësimin e kandidatëve.

Neni 21 **Pjesëmarrja nga përfaqësitë e huaja**

Përfaqësues të Delegacionit të Bashkimit Evropian dhe të Ambasadës së Shteteve të Bashkuara të Amerikës, në Tiranë, mund të marrin pjesë në seancat dëgjimore me kandidatët.

Neni 22 **Konfidencialiteti, mbrojtja e të dhënave dhe klasifikimi**

Procedurat e parashikuara në këtë udhëzim kryhen në përputhje me legjislacionin në fuqi për mbrojtjen e të dhënave personale dhe informacionin e klasifikuar. Dokumentet duhet të jenë të redaktuara para publikimit, në rast se përmbajnë informacion personal të kandidatëve ose informacion rreth personave të tjerë.

Neni 23 **Hyrja në fuqi**

Ky udhëzim hyn në fuqi në ditën e botimit në Fletoren Zyrtare.

MINISTËR I BRENDSSHËM
Ervin Hoxha

SHTOJCA A
PLATFORMA DHE VIZIONI I KANDIDATIT PËR DREJTOR TË PËRGJITHSHËM
TË POLICISË SË SHETIT

I. Vizioni, politikat dhe strategjitë në Policinë e Shtetit gjatë mandatit

1. Si e vlerësoni situatën në Policinë e Shtetit gjatë pesë viteve të fundit (kritikat janë të vlerësueshme).
2. Listoni përparësitë kryesore tuajat si Drejtor i Përgjithshëm i Policisë së Shtetit dhe arsyet e përzgjedhjes së tyre.
3. Evidentoni mangësitë e Policisë së Shtetit dhe adresimin e zgjidhjeve.
4. Cilat janë sfidat e Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit gjatë mandatit.

II. Aftësia drejtuese dhe lidershipi për të udhëhequr Policinë e Shtetit gjatë periudhës së mandatit

1. Cili është misioni dhe vizioni juaj gjatë mandatit,
2. Evidentoni vështirësitë e rolit tuaj, rreziqet dhe masat për kapërcimin e tyre.

III. Aftësitë menaxheriale gjatë periudhës së mandatit

1. Me qëllim përmbushjen e misionit dhe vizionit tuaj në krye të Policisë së Shtetit listoni pesë prioritetet kryesore dhe arsyen e përzgjedhjes.

IV. Vizioni për të menaxhuar burimet njerëzore në Policinë e Shtetit

Secili kandidat duhet të rendisë hapat që do të ndërmerren gjatë mandatit të Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit për të përmbushur objektivat kryesore:

1. Hapat që do të ndërmerren gjatë dy viteve të para;
2. Hapat që do të ndërmerren gjatë dy vjeçarit të dytë;
3. Hapat që do të ndërmerren deri në mbarimin e mandatit.

V. Përvoja praktike në çështjet e rendit ose sigurisë

1. Evidento përvojën e deritanishme,
2. Hapat të cilët do të ndërmerren për të rritur nivelin e besueshmërisë së publikut ndaj institucionit të Policisë së Shtetit.

Emri Mbiemri

Nënshkrimi

Data dhe vendi i nënshkrimit _____

SHTOJCA B

AUTORIZIM

Mbi verifikimin e figurës dhe integritetit

Unë i/e nënshkruari/a (emri, atësia, mbiemri), kandidat/e për Drejtor të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit, autorizoj Ministrinë e Brendshme/Komisionin e Posaçëm të kryejë verifikimin në të gjitha subjektet publike dhe private, brenda dhe jashtë territorit të Shqipërisë, të figurës dhe integritetit tim, si dhe çdo shkaku tjetër përjashtues.

Ky autorizim ka vlerë deri në përfundim të procesit të përzgjedhjes dhe propozimit të kandidatëve për Drejtor të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit, Kryeministrit.

Të gjitha veprimet për të kryer kontroll dhe për të siguruar të dhëna, të kryera nga Ministria e Brendshme apo persona/subjekte të autorizuar prej tij, i konsideroj sikur janë kryer nga unë vetë.

Autorizuesi

Data, vendi i nënshkrimit

Emër, mbiemër, nënshkrim

SHTOJCA C

FORMULAR

**PËR VLERËSIMIN E KANDIDATIT PËR DREJTOR TË PËRGJITHSHËM TË
POLICISË SË SHQIPTARË**

Kandidati/ja z./znj. _____

Nr.	Komponentët dhe elementet e vlerësimit	Pikët maksimale	Pikët e akorduara	
			Për çdo element	Për komponentin
1	Vlerësimi profesional	30	X	
	Kohëzgjatja dhe rëndësia/përshtatshmëria e eksperiencës në punë me pozicionin në të cilin konkurron.			
	Rezultatet e vlerësimeve profesionale ose etike të kandidatëve në pozicionet e mëparshme, nëse ka ose rezultatet e arritura gjatë përvojave			

	të tyre të punës që lidhen me ushtrimin e funksioneve në fushën e rendit ose sigurisë.			
	Rezultatet e arritura gjatë studimeve të tyre të larta si dhe në kurse trajnimi të certifikuar në Shqipëri dhe jashtë Shqipërisë.			
	Rezultatet e arritura gjatë studimeve pasuniversitare në fushën e rendit ose sigurisë.			
	Punime akademike, studime shkencore, shkrime dhe ligjërata profesionale, botime, pjesëmarrje në aktivitete shkencore, pjesëmarrje në procesin e hartimit ose të konsultimit të legjislationit dhe çdo angazhim tjetër profesional i kandidatit gjatë 5 viteve të fundit në fushën e rendit ose sigurisë.			
2	Vlerësimi moral dhe i integritetit	10	X	
	Reputacioni që kandidati gëzon në shoqëri dhe te kolegët, si rezultat i aktivitetit të tij profesional bazuar në cilësitë morale, si: ndershmëria, përpikëria në kryerjen e detyrave, drejtësia në marrjen e vendimeve, llogaridhënia.			
	Reputacioni që kandidati gëzon në shoqëri dhe te kolegët, si rezultat i aktiviteteve të kryera gjatë kohës që nuk ushtron funksionin e tij bazuar në cilësitë morale si besueshmëria, paanshmëria, dinjiteti, aktivitete bamirëse ose kulturore.			
3	Vlerësimi organizativ dhe drejtues	50	X	
	Cilësia e platformës dhe vizionit që ata paraqesin sipas shtojcës B të udhëzimit.			
	Aftësitë e provuara në marrjen e vendimeve dhe përgjegjësi, bazuar gjithashtu në përvojat e mëparshme profesionale dhe shoqërore.			
	Aftësitë në komunikim			
	Aftësia për të punuar në grup dhe në mjedise multidisiplinare dhe/ose multikulturore.			
	Aftësia për përfaqësim në publik.			
4	Elemente shtesë për vlerësim	10	X	
	Mbajtja e titujve akademikë			
	Studime dhe trajnime afatgjata të kryera jashtë vendit jo më pak se dy javë në fushën e rendit ose sigurisë ose menaxheriale.			
	Zotërimi i gjuhëve të huaja duke i dhënë përparësi gjuhëve zyrtare të Këshillit të Evropës.			
	TOTALI I PIKËVE	100		

Anëtar i Komisionit të Posaçëm

Emri Mbiemri